



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 58, datë 29. 09. 2022

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË AKTIVITETIT TË KËSHILLIT BASHKIAK
SKRAPAR PËR VITIN 2023”**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 29. 09. 2022, pasi mori në shqyrtim projektaktin e paraqitur nga Kryesia e Këshillit Bashkiak Skrapar, hartuar në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, duke pasur si qëllim kryesor përmbushjen me sukses të detyrave që burojnë nga ky ligj dhe në zbatim të rregulloreve për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Skrapar, Marrëdhënjet e Këshillit Bashkiak me publikun dhe median, Kodi i sjelljes dhe i parandalimit të konfliktit të interesave të këshilltarit bashkiak, Shqyrtimi dhe miratimi i peticioneve dhe iniciativave qytetare, Strukturat komunitare dhe ndërveprimet e tyre me Këshillin Bashkiak

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Aktivitetit të Këshillit Bashkiak Skrapar për vitin 2023, sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Këshilli Bashkiak Skrapar
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikes 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Vendimi u miratua me 11 vota pro , vota kundër - s'ka , votë abstenim – s'ka.

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .



KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK
Edlira SHKËMBI



Plani i Aktivitetit të Këshillit Bashkiak Skrapar për vitin 2023

Pershkrimi i aktivitetit	Periudha												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	
<p>Mbledhje Keshilli - 12</p> <p>1 në çdo muaj. të cilat thirren bazuar në neni 53</p> <p>Funksionimi i këshillit bashkiak, pika 2. Mbledhjet e radhës së këshillit bashkiak zhvillohen si rregull, sipas përcaktimit që bën vetë këshilli, por jo më pak se një herë në muaj + mbledhje jashtë radhe thirrur në zbatim të nenit 53, pika 3. Këshilli mbledhet në çdo rast: a) me kërkesën e kryetarit të bashkisë; b) me kërkesën me shkrim të jo më pak se 1/3 së anëtarëve të tij; c) me kërkesën e motivuar të prefektit për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij.</p>													
<p>Mbledhje Komisionit të Përhershëm (mesatarisht 4-5 mbledhje komisionesh në muaj)</p>													
<p>akime me komunitetin, konsultimet kerkuar nga ligji: buxhet, ndryshim buxheti, pakete fiskale- per cdo NjA dhe e biznesin, atite, blerje e dhenje me qera, norma e standarte te shperbimeve publike dhe funksioneve te tjera ligjore.</p>													



Ceremoni për dhënie titull nderi																		
Takime me veteranet dhe pjesëmarrje në festa e ngjarje vendore dhe kombetare																		
Pritje delegacioni nga keshilla homologe																		
Hartimi, miratimi i buxheti vjetor të KB për vitin 2023 dhe përcjellja për implementim në dokumentin final të buxhetit të bashkisë																		
Plotësimi i regjistrit të Ankesave, kërkesave dhe vërejtjeve (ligji nr. 139/2015, neni 19, ligji nr. 146/2014, neni 21)																		
Plotësimi i regjistrit të kërkesave për informim për dokumentacionin e keshillit (ligji 119/2014)																		
Plotësimi i regjistrit elektronik të p/akteve të shqyrtuara nga keshilli																		
Plotësimi i regjistrit elektronik të Vendimmarrjes nga keshilli																		
Plotësimi i regjistrit elektronik të Vendimmarrjes nga keshilli të konfirmuara nga institucioni i prefektit																		
Plotësimi i regjistrit elektronik të Vendimmarrjes nga keshilli të pakonfirmuara nga institucioni i prefektit																		
Aktivitetet me nxenesit me rezultate shumë të mira në mesime si dhe perkrahja e talentëve të reja në fusha të ndryshme me rastin e festave të fund vitit																		
Hartim i Dokumentit të politikës për shpenzimet e Keshillit dhe përdorimin e mjediseve dhe shërbimeve publike nga Keshilltaret																		
Anketimi vjetor për vlerësimin nga komuniteti të punës dhe rezultateve të Keshillit																		

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

Edlira SHKËMBI


